



**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUDSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**PRILL - QERSHOR
APRIL - JUN
2023**

II

**Buletini periodik i praktikës gjyqësore
të Gjykatës Kushtetuese**
(Prill– Qershor2023)

Buletiniperiodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuesepërmbanpërmbledhjen e aktgjykimeve dheaktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese eRepublikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në bazaperiodike dhe është përgatitur nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjykimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë publikuar në Gazetën Zyrtare tëRepublikës së Kosovës, dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen eGjykatësKushtetuese:www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohni në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

**Periodični bilten sudske
prakse Ustavnog suda**
(April - Jun2023. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovani prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu:Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internetstranici Suda:

https://gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/

Napomena:Svako ko želi da kopira, prevede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

"Perandori Justinian" nr. 44, 10 000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 60 61 62
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576
Fax: +383(0) 38 60 61 70
Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org
©Gjykata Kushtetuese 2023

Tabela e përmbajtjes / Pregled sadržaja

I - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

I - Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) Cenim i të drejtës për një „vendim të arsyetuar”

(i) Povreda prava na “obrazloženu odluku”

- Mos adresimi nga gjykatat e rregullta i pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës lidhur me kompensimin e të ardhurave që burojnë nga marrëdhënia e punës, ndërprerja e të cilës ishte vërtetuar si e kundërligjshme, ka rezultuar në shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Nerešavanje od strane redovnih sudova bitnih navoda podnosioca zahteva u pogledu naknade prihoda koji proizilaze iz radnog odnosa, čiji je prestanak utvrđen kao nezakonit, rezultirao je povredom prava na obrazloženu odluku, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: *povreda ustavnih prava.*

KI82/22, Parashtrues: Valon Loxhaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev.nr.103/2022], të 30 marsit 2022.....8
KI82/22, Podnosilac: Valon Loxhaj, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova [Rev.nr.103/2022] od 30. marta 2022. godine.....8

(ii) Cenimi i parimit të “gjykatës së themeluar me ligj”

(ii) Povreda načela “zakonom ustanovljenog suda”

- Vendimi i Gjykatës Supreme për të prishur aktgjykimet e shkallës më të ulët dhe refuzimii kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës, pa e kthyer çështjen në rigjykim, ashtu siç parashihet me liegjislacionin në fuqi, ka cenuar parimin e “gjykatës së themeluar me ligj”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Odlukom Vrhovnog suda da ukinu presude nižeg stepena i da odbije tužbeni zahtev podnosioca, bez vraćanja slučaja na presuđivaenje, kako je predviđeno važećim zakonodavstvom, povređeno je načelo „zakonom ustanovljenog suda“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: *povreda ustavnih prava.*

KI14/22, Parashtrues: Shpresa Gërvalla, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 409/2020], të 28 shtatorit 2021.....11
KI14/22, Podnosilac: Shpresa Gërvalla, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova [Rev. nr. 409/2020] od 28. septembra 2021. godine.....11

(iii) Cenimi i parimit të “barazisë së armëve” dhe të “kontradiktoritetit procedural”

(iii) Povreda načela “jednakosti oružja” i “procesne kontradiktornosti”

- Mos shqyrtimi nga Gjykata e Apelit e përgjigjes së parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së palës kundërshtare, ka cenuar parimin e “barazisë së armëve” dhe parimin e “kontradiktoritetit”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Nerazmatranje od strane Apelacionog suda odgovora podnosioca zahteva na žalbu suprotne strane povredilo je načelo „jednakosti oružja“ i načelo „kontradiktornosti“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: povreda ustavnih prava.

KI67/22, Parashtrues: Zeqirja Prebreza, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [CA. Nr. 1343/2021] të 29 dhjetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës.....15

KI67/22, Podnosilac: Zeqirja Prebreza, Ocena ustavnosti presude [CA. br. 1343/2021] od 29. decembra 2021. godine Apelacionog suda Kosova.....15

(iv) E drejta për seancë dëgjimore

(iv) Pravo na saslušanje

- Refuzimi për mbajtjen e seancës dëgjimore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, ka cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t’u dëgjuar, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Odbijanjem da se održi ročište u Posebnoj komori Vrhovnog suda povodom tužbe podnosioca zahteva povređeno je pravo podnosioca zahteva da bude saslušan, kao sastavni deo pravičnog suđenja: povreda ustavnih prava.

KI41/22, Parashtrues: Shkumbin Qehaja, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0867-A001] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 10 marsit 2022.....17

KI41/22, Podnosilac: Shkumbin Qehaja, Ocena ustavnosti presude [AC-I-21-0867-A001] Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda Kosova od 10. marta 2022. godine.....17

II - Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

II - Član 29 [Pravo na Slobodu i Sigurnost]

(i) Cenimi i të drejtës së lirisë dhe sigurisë

(i) Povreda prava na slobodu i sigurnost

- Mos adresimi i një pretendimi thelbësor të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me afatin ligjor për mbajtje në paraburgim të parashtruesit të kërkesës para ngritjes së aktakuzës, ka cenuar të drejtën e tij për liri dhe siguri: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Nerešavanjem bitnog navoda podnosioca zahteva, koji se odnosi na zakonski rok za pritvor podnosioca zahteva pre podizanja optužnice, povređeno je njegovo pravo na slobodu i sigurnost: povreda ustavnih prava.

KI85/22, Parashtrues: Jadran Kostić, Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktvendimit 2022:19820, të 17 majit 2022, të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktvendimit Pn1 Nr. 704/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 31 majit 2022.....22

KI85/22, Podnosilac zahteva: Jadran Kostić, Ocena ustavnosti rešenja 2022:19820 od 17. maja 2022. godine Osnovnog suda u Uroševcu i rešenja Pn1 br. 704/2022 Apelacionog suda Kosova od 31. maja 2022. godine22

III- Neni 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

III- Član 45 [Pravo na Izbor i Učešće]

(i) Parimet e përgjithshme zgjedhore dhe për përfaqësim të komuniteteve jo-shumicë

(i) Opšta izborna načela i zastupljenost nevećinskih zajednica

- Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe anulimi/shpallja e pavlefshme e fletëvotimeve mund të bëhet vetëm sipas legjislacionit në fuqi dhe në harmoni me parimet e përcaktuara në Kushtetutë: nuk ka shkelje të të drejtave kushtetuese.
- Glasanje je lično, jednako, slobodno i tajno, a poništavanje/proglašavanje glasačkih listića nevažećim može se izvršiti samo u skladu sa zakonima koji su na snazi i u skladu sa načelima definisanim Ustavom: nema povrede ustavnih prava.

KI69/21, Parashtrues: Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA.nr.29/2021], të 12 marsit 2021.....25

KI69/21, Podnosilac zahteva: Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova [AA. br. 29/2021] od 12. marta 2021. Godine.....25

IV- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

IV - Član 46 [Zaštita imovine]

Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) Parimi i “gjykatës së themeluar me ligj” dhe e drejta përkompensim për pronën e shpronësuar

(i) Načelo „zakonom ustanovljenog suda“ i pravo na naknadu za eksproprijisanu imovinu

- Trajtimi i revizionit të palës nga Gjykata Supreme në mungesë të juridiksionit të përcaktuar me ligj, cenon parimin e “gjykatës së themeluar me ligj” si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë, ndërsa vonesa në dhënien e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për shpronësimin e paluajtshmërisë, përbën shkelje të së drejtës në pronë: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Postupanje reviziji strane od strane Vrhovnog suda u nedostatku zakonom utvrđene nadležnosti, povređuje načelo „zakonom ustanovljenog suda“ kao sastavnog dela pravičnog suđenja, dok odlaganje davanja neposredne i adekvatne naknade za eksproprijaciju nepokretnosti predstavlja povredu prava svojine: povredu ustavnog prava

KI212/21, Parashtrues: Behar Emmini, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 382/2021], të 22 shtatorit 2021.....40

KI212/21, Podnosilac zahteva: Behar Emmini, ocena ustavnosti rešenja Vrhovnog suda Kosova [Rev. br. 382/2021] od 22. septembra 2021. godine.....40

V - Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

V - Član 65 [Nadležnosti Skupštine]

(i) Roli Mbikëqyrës i Kuvendit

(i) Nadzorna uloga Skupštine

- Me rastin e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të Hekurudhave, Kuvendi ka vepruar në rolin mbikëqyrës ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe ka ushtruar funksionin e përcaktuar në Ligjin nr. 04/L -063 për Hekurudhat e Kosovës: jo shkelje kushtetuese.
- Povodom razrešenja članova Železničkog odbora, Skupština je vršila nadzornu ulogu definisanu stavom 9, člana 65. Ustava i vršila funkciju definisanu Zakonom br. 04/L -063 o Kosovskim železnicama: nije ustavna povreda.

KO139/21, Parashtrues: Fadil Nura dhe 9 deputetë të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 21 korrikut 2021, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.....45

KO139/21, Podnosilac zahteva: Fadil Nura i 9 drugih poslanika, Ocena ustavnosti odluke br. 08-V-040 Skupštine Republike Kosovo od 21. jula 2021. godine o razrešenju članova Odbora Železničkog regulativnog organa.....45

VI - Neni 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]

VI - Član 110 [Tužilački Savjet Kosova]

(i) Cenimi i pavarësisë kushtetuese të Këshillit Prokurorial të Kosovës
(i) Povreda ustavne nezavisnosti Tužilačkog saveta Kosova

- Delegimi i kompetencave për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial nga Kuvendi tek autoritetet tjera dhe shkurtimi i mandatit të anëtarëve aktualë tëtij, ka rezultat në cenim të pavarësisë së Këshillit Prokurorial: shkelje kushtetuese.
- Prenoshnje ovlašćenja za izbor članova Tužilačkog saveta iz Skupštine na druge organe i skraćivanje mandata njegovim dosadašnjim članovima dovodi do povrede nezavisnosti Tužilačkog saveta: povreda Ustava.

Parashtruesit: KO100/22, me parashtrues: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe KO101/22, Paraashtrues: Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.....49

Podnosiocu: KO100/22, sa podnosiocima zahteva: Abelard Tahiri i 10 drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo; i br KO101/22, sa podnosiocima zahteva: Arben Gashi i 10 drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo.....49

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenim i së drejtës për një “vendim të arsyetuar”

KI82/22, Parashtrues: Valon Loxhaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev.nr.103/2022] të 30 marsit 2022.

Mos adresimi nga gjykatat e rregullta i pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës lidhur me kompensimin e të ardhurave që burojnë nga marrëdhënia e punës, ndërprerja e të cilës ishte vërtetuar si e kundërligjshme, ka rezultuar në shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: shkelje e të drejtave kushtetuese.

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest pune, përkatësisht largimin e parashtruesit të kërkesës nga vendi i punës si Zyrtarit Kreditor në ProCredit Bank, më 15 dhjetor 2010. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatë Komunale në Prishtinë duke kërkuar (i) kthim në vendin e mëparshëm të punës; si dhe (ii) kompensim të të ardhurave personale të papaguara së bashku me kërkesat tjera aksesore. Gjykata Komunale e kishte miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke urdhëruar (i) kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e mëparshëm të punës; si dhe (ii) kompensimin e të ardhurave personale mujore të papaguara dhe kërkesat tjera aksesore. Pas ankesës së palës së paditur ProCredit Bank, Gjykata e Apelit (i) kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale sa i përket kthimit në vendin e punës; ndërsa (ii) kishte urdhëruar që çështja që ndërlidhet me kompensimin e të ardhurave personale të parashtruesit të kërkesës të kthehet në rivendosje. Në procedurën e rivendosjes, Gjykata Themelore në Prishtinë sërish kishte miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e një pjese të të ardhurave

Çlan 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda načela “pristupa sudu”

KI82/22, Podnosilac: Valon Loxhaj, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova [Rev.nr.103/2022] od 30. marta 2022. godine

Nerešavanje od strane redovnih sudova bitnih navoda podnosioca zahteva u pogledu naknade prihoda koji proizilaze iz radnog odnosa, čiji je prestanak utvrđen kao nezakonit, rezultirao je povredom prava na obrazloženu odluku, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: povreda ustavnih prava.

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja povezane su sa radnim sporom, odnosno sa otpuštanjem podnosioca zahteva sa njegovog radnog mesta kreditnog službenika u ProCredit Bank, dana 15. decembra 2010. godine. Kao rezultat toga, podnosilac zahteva je podneo tužbu Opštinskom sudu u Prištini, kojom je tražio (i) vraćanje na prethodno radno mesto; kao i (ii) naknadu neisplaćenih ličnih dohodaka zajedno sa drugim sporednim potraživanjima. Opštinski sud je usvojio kao osnovan tužbeni zahtev podnosioca zahteva, te naložio (i) vraćanje podnosioca zahteva na prethodno radno mesto; kao i (ii) naknadu neisplaćenih mesečnih ličnih dohodaka i ostalih sporednih potraživanja. Nakon žalbe tužene strane ProCredit Bank, Apelacioni sud je (i) potvrdio presudu Opštinskog suda u pogledu vraćanja na radno mesto; i (ii) naložio da se pitanje koje se odnosi na naknadu ličnih dohodaka podnosioca zahteva vrati na ponovno odlučivanje. U postupku ponovnog odlučivanja, Osnovni sud u Prištini je ponovo usvojio tužbeni zahtev podnosioca zahteva za naknadu jednog dela neisplaćenih ličnih dohodaka za period od 2012. do 2016. godine, te odbio tužbeni zahtev podnosioca zahteva za preostali deo ličnih dohodaka koji su takođe bili povezani sa dohocima koje je isti ostvario za period od 1. septembra 2012. do 30. septembra 2016. godine, kao član Odbora u Regionalnoj kompaniji “Ambienti” a.d. Nakon žalbi podnosioca zahteva i tužene strane,

personale të papaguara për periudhën 2012 deri 2016, ndërsa e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për pjesën tjetër të të ardhurave personale që gjithashtu ndërlihdeshin me të ardhurat që i njëjti kishte realizuar për periudhën 1 shtator 2012 deri 30 shtator 2016, si anëtar Bordi në kompaninë regjionale “Ambienti” sh.a. Pas ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme duke kërkuar (i) pagesën e të ardhurave personale nga 15 dhjetori 2010 deri në 31 gusht 2012; si dhe (ii) dallimin në të ardhura personale përkitazi me periudhën nga 1 shtatori 2012 deri më 30 shtator 2016. Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Në procedurë para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës i kontestoi vendimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe duke theksuar, ndër tjerash, se (i) ProCredit Bank në mënyrë të kundërligjshme e largoi atë nga puna; dhe se (ii) gjykatat e rregullta nuk i kishin akorduar kompensim përkitazi me periudhën nga 15 dhjetori 2010 deri më 31 gusht 2012 dhe i kishin reduktuar pagesën e pagave si rezultat i të ardhurave në mënyrë të paqartë dhe të paarsyetuar, duke përfshirë gjatë periudhës që kishte përfituar të hyra nga “Ambieni” sh.a. gjatë periudhës nga 1 shtatori 2012 deri më 30 shtator 2016.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kuadër të së drejtës për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në këtë kontekst (i)

Apelacioni sud je potvrdio presudu Osnovnog suda. U međuvremenu, podnosilac zahteva je podneo reviziju Vrhovnom sudu, kojom je tražio (i) isplatu ličnih dohodaka za period od 15. decembra 2010. do 31. avgusta 2012. godine; kao i (ii) razliku u ličnim dohocima u odnosu na period od 1. septembra 2012. do 30. septembra 2016. godine. Vrhovni sud je odbio reviziju podnosioca zahteva kao neosnovanu.

Žalba podnosioca zahteva

U postupku pred Sudom, podnosilac zahteva je osporio odluke redovnih sudova, navodeći da je došlo do povrede članova 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje], 32. [Pravo na pravno sredstvo] i 54. [Sudska zaštita prava] Ustava u vezi sa članovima 6. (Pravo na pravično suđenje) i 13. (Pravo na delotvorni pravni lek) Evropske konvencije o ljudskim pravima, i naglašavajući, između ostalog, (i) da ga je ProCredit Bank nezakonito otpustila sa posla; i (ii) da redovni sudovi nisu dosudili naknadu u odnosu na period od 15. decembra 2010. do 31. avgusta 2012. godine i da su na nejasan i neobrazložen način umanjili isplatu plata kao rezultat prihoda, uključujući i period u kome je ostvarivao prihode od “Ambienti” a.d. tokom perioda od 1. septembra 2012. do 30. septembra 2016. godine.

Nalazi Suda

Sud je navode podnosioca zahteva ocenio u kontekstu prava na obrazloženu odluku, koje je zagarantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima i u tom kontekstu (i) najpre razradio opšta načela u pogledu prava na obrazloženu odluku zagarantovanog Ustavom i Evropskom konvencijom o ljudskim pravima, a zatim (ii) primenio ista na okolnosti konkretnog slučaja. U tom kontekstu, Sud je najpre stavio naglasak na činjenicu da poništenje i proglašavanje nezakonitim obaveštenja tužene ProCredit Bank od 15. decembra 2010. godine o prestanku radnog odnosa podnosioca zahteva i vraćanje istog na prethodno radno mesto predstavljaju presuđene stvari, odnosno *res judicata*, zbog toga što je presudom [Ac. br.

së pari shtjelloi parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është e garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe më pas (ii) i zbatoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vuri theks në faktin që anulimi dhe shpallja e kundërligjshme e njoftimit të të paditurës ProCredit Bank, të 15 dhjetorit 2010, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës dhe kthimi i të njëjtit në vendin e mëparshëm të punës, janë çështje të gjykuara, përkatësisht res judicata, sepse përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1955/13] të 27 qershorit 2016 të Gjykatës së Apelit, ishte vërtetuar Aktgjykimi përkatës i Gjykatës Komonale, ndërsa rasti ishte kthyer në rivendosje vetëm sa i përket kompensimit të pagave të parashtruesit të kërkesës. Ndërsa, për sa i përket të drejtës për vendim të arsyetuar, Gjykata konstatoi që në rrethanat e rastit konkret, gjykatat e rregullta kishin dështuar të adresojnë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës lidhur me (i) kompensimin e të ardhurave që burojnë nga marrëdhënia e punës, ndërprerja e të cilës ishte vërtetuar si e kundërligjshme përmes vendimeve të formës së prerë, për periudhën prej 15 dhjetorit 2010 deri 31 gusht 2012; (ii) vlerësimin të kompensimit të nevojshëm të të ardhurave për periudhën prej 31 gushtit 2012 deri 30 shtator 2016, përgjatë së cilës parashtruesi i kërkesës kishte realizuar të ardhura edhe nga kompania regionale "Ambienti" sh.a.. Gjykata, duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore, ritheksoi që përderisa nuk është detyrim i gjykatave që të adresojnë dhe arsyetojnë secilin pretendim të palëve përkatëse, ato megjithatë kanë detyrimin kushtetues që të adresojnë dhe arsyetojnë, pretendimet thelbësore të palëve. Gjykata theksoi që në rrethanat e rastit konkret, ky nuk ishte rasti.

Përfundimi

Për pasojë, bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se (i) Aktgjykimi [Ac. nr. 1955/13] i Gjykatës së Apelit i 27 janarit 2016 lidhur me anulimin e njoftimit të 15 dhjetorit 2010 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin në vendin e

1955/13] Apelacionog suda od 27. juna 2016. godine potvrđena relevantna presuda Opštinskog suda, a predmet vraćen na ponovno odlučivanje samo u odnosu na naknadu zarade podnosioca zahteva. Što se pak tiče prava na obrazloženu odluku, Sud je utvrdio da su u okolnostima konkretnog slučaja redovni sudovi propustili da odgovore na suštinske navode podnosioca zahteva koji su se odnosili na (i) naknadu prihoda koji proizilaze iz radnog odnosa, čiji raskid je potvrđen kao nezakonit pravosnažnim odlukama, za period od 15. decembra 2010. do 31. avgusta 2012. godine; (ii) procenu potrebne naknade ličnih dohodaka za period od 31. avgusta 2012. do 30. septembra 2016. godine, u kome je podnosilac zahteva ostvarivao prihode i od regionalne kompanije "Ambienti" a.d. Sud je, oslanjajući se na svoju sudsku praksu, ponovio da iako nije dužnost sudova da sagledaju i obrazlože svaki navod dotičnih stranaka, oni ipak imaju ustavnu odredbu da sagledaju i obrazlože suštinske navode stranaka. Sud je istakao da u okolnostima konkretnog predmeta to nije slučaj.

Zaključak

Kao rezultat toga, a i na osnovu objašnjenja datih u objavljenoj presudi, Sud je utvrdio (i) da je presuda [Ac. br. 1955/13] Apelacionog suda od 27. januara 2016. godine u odnosu na poništenje obaveštenja od 15. decembra 2010. godine o prestanku radnog odnosa i vraćanje na prethodno radno mesto *res judicata*, a da je (ii) presuda [REV. br. 103/2022] Vrhovnog suda od 30. marta 2022. godine u vezi sa presudom [Ac. br. 504/19] Apelacionog suda i presudom [C. br. 1507/16] Osnovnog suda u Prištini od 22. oktobra 2018. godine, donete u suprotnosti sa procesnim garancijama utvrđenim stavom 1. člana 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa stavom 1. člana 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima, zbog nepostojanja obrazložene sudske odluke i da se shodno tome proglašavaju ništavim i predmet vraća Osnovnom sudu u Prištini na ponovno odlučivanje.

mëparshëm të punës, është *res judicata*, ndërsa (ii) Aktgjykimi [REV.nr.103/2022] i Gjykatës Supreme i 30 marsit 2022 në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 504/19] të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 1507/16] e Gjykatës Themelore në Prishtinë të 22 tetorit 2018, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së një vendimi gjyqësor të arsyetuar, dhe për pasojë, shpallen të pavlefshme dhe çështja kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenimi i parimit të “gjykatës së themeluar me ligj”

KI14/22, Parashtrues: Shpresa Gërvalla, Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 409/2020] të 28 shtatorit 2021

Vendimi i Gjykatës Supreme për të prishur aktgjykimet e shkallës më të ulët dhe refuzimi i kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës pa e kthyer çështjen në rigjykim, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi, ka cenuar parimin e “gjykatës së themeluar me ligj” si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë: *shkelje e të drejtave kushtetuese*.

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me padinë e parashtrueses së kërkesës “*për lëndimin e pësuar në vendin e punës*” dhe për kompensimin për dëm jo-material, e cila gjatë kohës sa kishte qenë e punësuar si arkëtare e divizionit të Korporatës Energjetike të Kosovës, më 18 nëntor 2011, gjatë orarit të punës, ishte rrëzuar në shkallët e objektit të Raiffeisen Bank

Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda načela “zakonom ustanovljenog suda”

KI14/22, Podnosilac: Shpresa Gërvalla, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova [Rev. nr. 409/2020] od 28. septembra 2021. godine

Odlukom Vrhovnog suda da ukinu presude nižeg stepena i da odbije tužbeni zahtev podnosioca, bez vraćanja slučaja na presuđivaenje, kako je predviđeno važećim zakonodavstvom, povređeno je načelo „zakonom ustanovljenog suda“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: *povreda ustavnih prava*.

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na tužbu podnositeljke zahteva „*za povredu zadobijenu na radnom mestu*” i za naknadu nematerijalne štete, koja je za vreme, dok je bila u radnom odnosu na poslovima blagajnika divizije Energetske korporacije Kosova, 18. novembra 2011. godine, tokom radnog vremena, pala sa stepenica objekta Raiffeisen banke u Kosovu Polju i zadobila telesne povrede.

në Fushë-Kosovë dhe kishte pësuar lëndime trupore.

Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar padi kundër “Raiffeisen Bank” në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përmes së cilës kërkoi dëmshpërblim për lëndimin trupor. Gjykata Themelore aprovoi pjesërisht padinë e parashtrueses së kërkesës “për lëndimin e pësuar në vendin e punës” dhe për kompensim për dëmin jo-material, ndërsa refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua nga Gjykata e Apelit. Megjithatë, si rezultat i revizionit të parashtruar nga ana e “Raiffeisen Bank” në Gjykatën Supreme, kjo e fundit pranoi si të bazuar revizionin dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës për shkak të (i) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, përkatësisht të neneve 173 (Prezumimi i kauzalitetit) dhe 174 (Kush përgjigjet për dëmin) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 192 (Përgjegjësia e pjesëtuar) të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (i shpallur më 30 mars 1978); (ii) vlerësimin të gabuar të gjendjes faktike, duke arsyetuar se parashtruesja e kërkesës ishte duke kryer detyrat e punës si arkëtare e Divizionit të KEK-ut; dhe se në rastin konkret (iii) nuk ishte vërtetuar përgjegjësia e “Raiffeisen Bank” në raport me lëndimet e marra nga parashtruesja e kërkesës.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës pretendoi se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të

Neutvrëdenog datuma, podnositeljka zahteva je podnela tužbu protiv Raiffeisen banke Osnovnom sudu u Prištini, kojom je tražila naknadu za telesnu povredu. Osnovni sud je delimično usvojio tužbu podnositeljke zahteva „za povredu zadobijenu na radnom mestu“ i za naknadu nematerijalne štete, dok je u ostalom delu tužbeni zahtev odbio. Presudu Osnovnog suda je potvrdio Apelacioni sud. Međutim, kao rezultat revizije koju je Raiffeisen banka podnela Vrhovnom sudu, poslednje navedeni je reviziju usvojio, kao osnovanu, i preinačio presude Apelacionog suda i Osnovnog suda, odbijajući tužbeni zahtev podnositeljke, kao neosnovan, zbog (i) pogrešne primene materijalnog prava Osnovnog suda i Apelacionog suda i to člana 173. (Pretpostavka uzročnosti) i 174. (Ko odgovora za štetu) u odnosu na stav 1 člana 192. (Podeljena odgovornost) Zakona o obligacionim odnosima (proglašen 30. marta 1978. godine); (ii) pogrešnog utvrđivanja činjeničnog stanja, obrazlažući da je podnositeljka zahteva obavljala svoje dužnosti kao blagajnik divizije EKK-a; i da u konkretnom slučaju (iii) nije utvrđena odgovornost Raiffeisen banke u vezi sa povredama koje je zadobila podnositeljka zahteva.

Žalba podnosioca zahteva

Podnositeljka zahteva je pred Sudom navodila da su joj povređena osnovna prava i slobode zagarantovane članovima 3. [Jednakost pred zakonom] i 24. [Jednakost pred zakonom] Ustava Republike Kosovo u vezi sa članom 14. (Zabrana diskriminacije) Evropske konvencije o ljudskim pravima, kao i članovima 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] i 54. [Sudska zaštita prava] Ustava u vezi sa članovima 6. (Pravo na pravično suđenje) i 13. (Pravo na delotvorni pravni lek) Evropske konvencije o ljudskim pravima, jer: (i) osporena presuda Vrhovnog suda predstavlja suđenje u predmetu koji se odnosi na pogrešno ili nepotpuno utvrđivanje činjeničnog stanja, za koji revizija nije dozvoljena; i da (ii) je

Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që: (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ngërthen gjykim të çështjes që ka të bëjë me konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për çka revizioni nuk është i lejuar; dhe se (ii) Gjykata Supreme në këtë rast, çështjen është dashur ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës më të ulët, siç përcaktohet saktësisht në ligjin e aplikueshëm. Nga pretendimet e lartcekura të parashtrueses së kërkesës rezulton që, çështjet e ngritura në kërkesën e saj ndërlidhen me tejkalimin e kompetencës të përcaktuar me ligj të Gjykatës Supreme, të cilat pretendime në thelb ndërlidhen me kriterin e së drejtës për një “gjykatë të themeluar me ligj”, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat Njeriut.

Gjetjet e Gjykatës

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi dhe pastaj aplikoi në rastin konkret (i) parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me parimin e “gjykatës së themeluar me ligj”; dhe (ii) dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore që ndërlidhen me juridiksionin dhe vendimmarrjen e Gjykatës Supreme gjatë procedurës së revizionit, sipas së cilave, ndër tjerash, një gjykatë nuk mund të vendos jashtë juridiksionit të saj të përcaktuar me ligj.

Në aplikimin e këtyre parimeve Gjykata fillimisht konstatoi se, Gjykata Supreme kishte juridiksion për të vendosur në lidhje me revizionin e palës së paditur. Megjithatë, në

Vrhovni sud u ovom slučaju trebalo da vrati predmet nižem sudu na presuđivanje kako je precizno definisano u važećem zakonu. Iz gore navedenih tvrdnji podnositeljke zahteva, proizilazi da se pitanja koja se postavljaju u njenom zahtevu odnose na prekoračenje zakonom utvrđene nadležnosti Vrhovnog suda, a koje se u suštini odnose na pravi kriterijum za „zakonom ustanovljen sud“, garantovano stavom 2 člana 31. Ustava u vezi sa stavom 1 člana 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima.

Nalazi Suda

Ocenjujući navode podnositeljke zahteva, Sud je prvo razradio, a zatim primenio u konkretnom slučaju (i) opšta načela svoje sudske prakse i prakse Evropskog suda za ljudska prava u vezi sa načelom „zakonom ustanovljen sud“; i (ii) relevantne odredbe Zakona o parničnom postupku koje se odnose na nadležnost i donošenje odluka Vrhovnog suda tokom postupka revizije, prema kojima, između ostalog, sud ne može odlučivati van svoje zakonske nadležnosti.

U primeni ovih načela, Sud je prvo utvrdio da je Vrhovni sud nadležan da odlučuje o reviziji tužene. Međutim, u smislu stava 2 člana 224. [bez naslova] Zakona o parničnom postupku, ova odredba se odnosi na nadležnost Vrhovnog suda u kontekstu njegovog odlučivanja, da kada ukoliko revizionarna komisija konstatuje da zbog pogrešne primene materijalnog prava ili zbog kršenja proceduralnih pravila, faktičko stanje nije potpuno potvrđeno i da iz tog razloga ne postoje uslovi za promenu pobijene presude, Vrhovni sud je morao predmet vratiti na presuđivanje nižestepenim sudovima.

Kao rezultat odluke Vrhovnog suda da ukine presude nižeg stepena i odbije tužbeni zahtev podnositeljke bez vraćanja slučaja na presuđivanje, isti je povredio načelo „zakonom ustanovljen sud“. Štaviše, u smislu garancija definisanih stavom 2 člana 31. Ustava u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim

kuptim të paragrafit 2 të nenit 224 [pa titull] të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dispozitë kjo që i referohet kompetencës së Gjykatës Supreme në kontekst të vendimmarrjes së saj, me ç'rast kur gjykata e revizionit konstaton se, për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale apo për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjyqimit të goditur, Gjykata Supreme është dashur që çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatat e shkallës më të ulët.

Si rezultat i vendimit të Gjykatës Supreme për të prishur aktgjyqimet e shkallës më të ulët dhe refuzimin e kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës pa e kthyer çështjen në rigjykim, e njëjta ka cenuar parimin e “*gjykatës së themeluar me ligj*”. Për më tepër, në kuptim të garancive të përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, garanci këto që ndërliken edhe me parimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, kthimi i çështjes në rivendosje do t'i mundësonte palëve ndërgjyqëse, e në veçanti parashtrueses së kërkesës, që në pajtim me parimin e kontradiktoritetit, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të paraqesin parashtrësas dhe argumentet e tyre në lidhje me rastin.

Përfundimi

Përfundimisht, bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.409/2020] i 28 shtatorit 2021, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në kundërshtim me parimin e “*gjykatës së themeluar me ligj*”, pasi

pravima, koje se odnose i na načelo pravne sigurnosti i pravilnog sprovođenja pravde, vraćanje slučaja na presuđivanje bi omogućilo stranama u postupku, a posebno podnositeljki zahteva, da u skladu sa načelom kontradiktornosti, zagantovanim članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, podnesu podneske i svoje argumente u vezi sa slučajem.

Zaključak

Konačno, na osnovu pojašnjenja datih u objavljenoj presudi, Sud je zaključio da presuda Vrhovnog suda [Rev. br. 409/2020] od 28. septembra 2021. godine nije u saglasnosti sa članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima i u suprotnosti je sa načelom „*zakonom ustanovljen sud*“, pošto je Vrhovni sud prekoračio nadležnost definisanu stavom 2 člana 224. Zakona o parničnom postupku, tako što predmet nije vratio na presuđivanje nižestepenim sudovima prema utvrđenjima definisanim u važećem zakonu. Ova presuda je dopunjena i sa suprotnim mišljenjem.

që Gjykata Supreme ka tejkaluar kompetencën e saj të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 224 të Ligjit për Procedurën Kontestimore duke e mos e kthyer rastin për rishqyrtim në gjykatat e shkallës më të ulët sipas përcaktimeve të ligjit të aplikueshëm. Ky Aktgjykim është plotësuar edhe me mendim mospajtues.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenimi i parimit të “barazisë së armëve” dhe të “kontradiktoritetit procedural”

KI67/22, Parashtrues: Zeqirja Prebreza, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [CA. Nr. 1343/2021] të 29 dhjetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës

Mos shqyrtimi nga Gjykata e Apelit i përgjigjes së parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së palës kundërshtare, ka cenuar parimin e “barazisë së armëve” dhe parimin e “kontradiktoritetit”, si pjesë përbërëse të një gjykimi të drejtë: *shkelje e të drejtave kushtetuese*.

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës, pasi kjo e fundit kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për njohjen e të drejtës në kompensim të tri pagave jubilarë. Gjykata Themelore kishte aprovuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar, ndërsa duke vepruar sipas ankesës së Korporatës Energjetike të Kosovës, Gjykata e Apelit ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Bazuar në shkresat e lëndës përkatëse, në ankesën e paraqitur para Gjykatës së Apelit nga Korporata Energjetike e Kosovës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje në ankesë. Megjithatë, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të njëjtën nuk e

Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda načela “jednakosti oružja” i “procesne kontradiktornosti”

KI67/22, Podnosilac: Zeqirja Prebreza, Ocena ustavnosti presude [CA. br. 1343/2021] od 29. decembra 2021. godine Apelacionog suda Kosova

Nerazmatranje od strane Apelacionog suda odgovora podnosioca zahteva na žalbu suprotne strane povredilo je načelo „jednakosti oružja“ i načelo „kontradiktornosti“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja: *povreda ustavnih prava*.

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na tužbeni zahtev podnosioca protiv Energetske korporacije Kosova, pošto je poslednje navedena odbila zahtev podnosioca za priznavanje prava na naknadu za tri jubilarne plate. Osnovni sud je usvojio tužbu podnosioca zahteva, kao osnovanu, a postupajući po žalbi Energetske korporacije Kosova, Apelacioni sud je preinačio presudu Osnovnog suda i odbio tužbeni zahtev podnosioca, kao neosnovan. Na osnovu spisa relevantnog predmeta, na žalbu koju je Apelacionom sudu podnela Energetska korporacija Kosova, podnosilac zahteva je podneo odgovor, međutim, presudom Apelacionog suda isti nije razmotren, štaviše, utvrđeno je da ga nije podneo relevantni podnosilac zahteva. .

Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva pred Sudom osporava gore navedenu presudu Apelacionog suda, tvrdeći

kishte shqyrtuar, për më tepër, kishte konstatuar që një përgjigjee tillë nuk ishte paraqitur nga parashtruesi.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me (i) paragrafët 1 dhe 2 të nenit 24 [Barazia para Ligjit]; (ii) paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) paragrafin 1 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në esencë, për shkak të: (i) mungesës së shqyrtimit të përgjigjes së tij në ankesën e ushtruar nga pala kundërshtare dhe si pasojë, shkeljes së parimit të “barazisë së armëve”; (ii) zbatimin e gabuar të ligjit; si dhe (iii) mungesës të konsistencës, përkatësisht divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

Gjetjet e Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata u fokusua në pretendimet që kishin të bënin me parimin e “barazisë së armëve” dhe parimin e “kontradiktoritetit”, si rezultat i mos shqyrtimit nga Gjykata e Apelit të përgjigjes së parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së palës kundërshtare, duke elaboruar fillimisht (i) parimet e përgjithshme përkitazi me “barazinë e armëve” dhe parimin e “kontradiktoritetit” procedural, të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe më pas (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Bazuar në këto parime, Gjykata së pari

povredu nje govih prava zaštićenih (i) stavovima 1 i 2 člana 24. [Jednakost pred zakonom]; (ii) stavovima 1 i 2 člana 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava Republike Kosovo u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima; i (iii) stavom 1. člana 46. [Zaštita imovine] Ustava, u suštini, zbog: (i) nerazmatranja njegovog odgovora na žalbu suprotne strane i, kao posledica toga, povrede načela “jednakost oružja”; (ii) pogrešne primene zakona; kao i (iii) nedostatka doslednosti, odnosno razlike u sudskoj praksi Apelacionog suda.

Nalazi Suda

Prilikom razmatranja navoda podnosioca zahteva, Sud se fokusirao na tvrdnje koje se odnose na načelo „jednakosti oružja“ i načelo „kontradiktornosti“, kao rezultat toga što Apelacioni sud nije razmatrao odgovor podnosioca zahteva podnet na žalbu suprotne strane, prvo razrađujući (i) opšta načela u pogledu „jednakosti oružja“ i načela procesne „kontradiktornosti“, zagarantovanih stavom 1. člana 31. Ustava u vezi sa stavom 1. člana 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima i relevantnom sudskom praksom Ustavnog suda i Evropskog suda za ljudska prava, a zatim (ii) iste primenio na okolnosti konkretnog slučaja. Polazeći od ovih načela, Sud je prvo razjasnio da je odgovor na žalbu podnosilac zahteva podneo u zakonskom roku i ocenio da je Apelacioni sud zbog toga što odgovor na žalbu nije razmatrao u presudi [CA. br. 1343/2021] od 29. decembra 2021. godine, propustio da garantuje primenu načela „jednakosti oružja“ i procesnog „načela kontradiktornosti“, jer je podnosilac zahteva stavljen u značajno nepovoljniji položaj u odnosu na suprotnu stranu, te je kao rezultat toga bio lišen mogućnosti da se realno i sadržajno suoči sa argumentima i tvrdnjama koje je iznela suprotna strana.

Zaključak

Shodno tome, Sud je utvrdio da osporena presuda Apelacionog suda treba da se proglasi

sqaroi që një përgjigje në ankesë ishte paraqitur nga parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor dhe vlerësoi se, Gjykata e Apelit për shkak të mos shqyrtimit të përgjigjes në ankesë përmes Aktgjykimit [CA. Nr. 1343/2021] të 29 dhjetorit 2021, ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të “barazisë së armëve” dhe “parimin e kontradiktoritetit” procedural, sepse parashtruesi i kërkesës është vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* palës kundërshtare, dhe si pasojë është privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtësor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga pala kundërshtare.

Përfundimi

